

PARASHTRIME

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

PROKURORE Elizabeta Imeraj, Drejtuese e Prokurorisë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Duke kuptuar më së miri, rëndësinë e procesit të rivlerësimit, si një ndër momentet më të rëndësishme të Reformës së Drejtësi, kuptoj dhe vlerësoj cdo institucion shtetëror të ngarkuar nga Kushteuta dhe Ligji për kryerjen e një procesi të tillë.

Në fakt, sic dhe parashikohet shprehimisht ne normat e sanksionuara në aktet si më poshtë:

- Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut,
- Kushtetura e Republikës së Shqipërisë,
- Ligji me Nr 84 viti 2016,

kam besuar dhe normalisht do parashtrij pretendimet e mia, në lidhje me respektimin e të drejtave të pamohueshme si më poshtë:

- E drejta për një proces të rregullt ligjor. (neni 6 i KEDNJ-se)
- E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. (neni 8 i KEDNJ – se).
- Ndalimi i diskriminimit. (neni 14 i KEDNJ se). Etj.

Ne Aneksin e kushtetutes, janë të parashikuara në mënyrë të plotë respektimi i parimeve që lidhen me procesin e rregullt ligjor, qofte dhe në kuadrin e procesit të rivlerësimit, parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit, parimi i mosdiskriminimit, parimi për barazim të armëve në proces etj.

Keto parime, si të tilla, janë të detyrueshme për tu zbatuar nga cdo organ ligjzbatues duke përfshirë dhe mekanizmin e rëndësishëm që i vjen në ndihmë këtij procesi, Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit.

Në fakt në parantezë të parashtrimeve të mia dhe kërkesës për prova, para Jush po ndaloj në një prezantim faktik të situatës në të cilën procesi i rivlerësimit më ka vendosur mua si subjekt rivlerësi.

Ushtrij funksionin e Prokurorit të Republikës së Shqipërisë që nga viti 2004, me mbarimin e Shkollës së Magjistraturës.

Në punën time si prokuror, jam hasur me vështirësi në drejtim të ushtrimit të detyrës për arsye nga me të ndryshmet, por në asnjë rast nuk jam gjetur përballë vështirësive totale të realizimit të detyrës apo mbrojtjes së vetes dhe familjes time sic po ndodh tani nga sulme të çuditshme të paraqitura me denoncime në copa letrash, apo emaile me emra të rremë, si Rrahim Shehu, Valentino Ymeri, apo me emrin e një qytetareje që në rreshtat e mëposhtëm do sqaroheni më shumë për përmbajtjen e denoncimeve të saj.

E impenjuar në maksimum në profesionin tim të prokurorit, e bindur në maksimum për domosdoshmerinë e persosjes në dije të fushës të cilën kam zgjedhur të bëj pjesë, e perkushtuar karshi cdo hetimi që zgjidh dhe evidenton një marrëdhënie juridike të cënuar, e impenjuar për të dhënë kontributin edhe në mesimin e brezave të rinj, e mbi të gjitha e perkushtuar karshi misionit sublim si nënë për rritjen dhe edukimin e femijeve të mi, nuk mundet dhe nuk qëndron të le veten dhe personalitetin tim të pikturuar keq, jo në përputhje me realitetin, nga anonimë apo dhe nga njëzë të shtyre për të bërë një gjë të tillë, të cilët kanë dhe mundet të kenë vetëm një synim ‘Përdorimin e sistemit të drejtësisë për të bërë një padrejtesi’.

Jam hasur gjate ketij procesi te rivleresimit, me konkluzione te quajtuar opinione apo gjetje, te cilat referojne burim prove, letra anonime, jam hasur gjate ketij procesi me cenim te jeteses personale edhe ne kushtet kur nuk ishte e nevojshme, jam hasur gjate ketij procesi edhe me perballjen e futjes se akteve te fallsifikuara ne dosje, me synimin per te arritur qellimin dashakeqes, por me lejoni qe jo vetem per respektin karshi vetes time, por mbi te gjitha per respektin karshi femijeve dhe familjareve te mi, te paraqes prokuroren Elizabeta Imeraj, nenen Elizabeta Imeraj, motren apo familjaren Elizabeta Imeraj.

Me lejoni te mbroj Dinjitetin Njerezor dhe Figuren qe e kam krijuar ne vite, per shkak te punes, sjelljes, menyres se te vepruarit e mbi te gjitha per shkak te edukimit qe me kane bere prinderit e mi.

Ritur ne nje familje, me babane oficer dhe mamane ekonomiste, e kuptoj me se miri disiplinën, ndergjegjen, respektin dhe dinjitetin qe duhet te karakterizoje nje njeri.

Kam hetuar ceshtje te ndryshme, dhe jam hasur me sulme te ndryshme, duke perfshire dhe ato politike, ku ne periudha te ndryshme kohore per shkak hetimesh jane perpjekur dhe te me intimidojne per shkak te origjines time nga Tropoja, jane perpjekur te vendosin sa ne nje rryme politike apo ne tjetren, jane perpjekur te me trembin ne menyra te ndryshme, por ne fakt ja kam arritur qe te jem e pacenueshme dhe jo sepse jam e forte, apo dhe e pandjeshme, por sepse jam dhe zbatoj gjithmone te drejten.

Une nuk mundet te pasqyrohem ne syte tuaj, si prokurori qe nuk permbush kriterin profesional pasi kam kaluar per kompetence me te drejte ne kendveshtrimin tim, dy ceshtje, vendimarrja per te cilat eshte ushtruar dhe nga institucione te tjera, pasi nuk eshte ashtu:

- Jam prokurori qe kam derguar pergjate viteve ne gjykim thuajse 180 njeqind e tetedhjetete te pandehur, dhe mundem te kem marre 2 dy apo 3 tre pafajesi.
- Jam prokurori qe kam ndjekur ceshtje te rendesishme dhe sensitive ne opinionin publik.
- Kam hetuar politikane, zyrtare ne nivele te larta, anetare te krimit te organizuar, terroriste etj.

Ky prokurori jam une, ky prokurori qe kam bere shume seanca gjyqesore me 9 nente te pandehur per terrorizem, dhe me sallen e mbushur plot me perkrahes se tyre.

Jam ky prokurori qe kam hetuar dhe perfaqesuar ne gjykim ceshtjen Shullazi, ate ceshtje, per te cilen me largimin tim nga detyra e prokurorit ne Prokurorine e Krimeve te Renda, askush nuk pranonte te konkludonte duke luajtur rolin e perfqesuesit te akuzes per te dhene konkluzionet perfundimtare.

Jam Drejtuesi i Prokurorise qe perkushtohem ne maksimum per te bere te mundur bashkepunimin dhe bashkerendimin nderinstitucional me qellim te miren e punes.

E ndersa si individ jam mamaja e dy femije te mi, qe vrapoj pas tyre ne cdo minute te kohes time te lire, per ti mesuar, per tu perkujdesur e per ti edukuar duke ju falur dashuri pafund.

Jam bija e tim eti, qe vrapoj pas tij, ne cdo moment. Jam bija e sime meje dhe perballojmë bashkë sfidën e madhe të sëmundjes së rëndë që po kalon që nga viti 2019.

Kjo jam UNE të Nderuar!

Krejt e ndryshme nga ajo qe rezulton nga denoncuesi i rreme Rrahim Shehu, Valentino Ymeri apo qyterja me emrin E.F etj.

Une nuk jam, dhe kurrsesi nuk mundet te jem prokurori apo individ qe ben pergjime, apo shantazhe ne kundersizim me ligjin, sepse ky individ nuk jam UNE, nuk e kam menduar ndonjehere dhe me duket absurde ta degjoj.

Ndaj më lejoni të tregoj veten time, punen time, dhe cdo gje timen ashtu sic jam une, me lejoni te paraqes provat per te konkluduar se UNE jam keshtu, sic femijet me njohin, sic familjaret me njohin, sic koleget ku punoj me njohin dhe sic komuniteti ku jetoj me njeh.

Në kuadër të zhvillimit të procesit të rivlerësimit tim, si prokuror i RSH - se dhe Subjekt i Ligjit nr. 84/2016, aktualisht në rivlerësim që nga viti 2018, kam konsideruar në shumë raste dhe në mënyrë të përsëritur e dokumentuar dhe pjese e dosjes se hetimit, se Komisionerë, ish-

Komisionerë dhe vëzhgues ndërkombëtarë, në mënyrë aktive dhe të pashpjegueshme, kanë ndërmarrë veprime aktive, të parregullta, paragjyquese dhe me ndikim thelbësor në drejtim të moszhvillimit të një procesi të rregullt ligjor dhe zhvillimin e një vettingu, sipas kornizës Kushtetuese dhe Ligjore.

Nga njohja e plotë me aktet e përfutuara nga hetimi disa vjeçar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si edhe nga marrja e të gjitha të dhënave shkresore të cilat paraqesin relevancë dhe ndikim me procesin tim të rivlerësimit, konstatohen dukshëm praktika të konsoliduara sjelljesh, të cilat pasi duhen analizuar dhe vlerësuar edhe me rezultatet e nxjerra nga Insitucioniet. Ky lloj ndikimi i parregullt evidentohet se ka qenë pjesë e vijueshme e këtij procesi, e sidomos pas perfundimit me konfirmim ne detyre me date 25.03.2021, shpallur vendimi me date 01.04.2021.

MBI PROCESIN E RREGULLT LIGJOR

Konstatime dhe Rrethana Fakti :

I. Për të parashtruar këtë kërkesë timen, krahas të tjerash, kam marrë shkas nga informacioni i bërë publik në media, i dalë pas përfundimit të procesit të rivlerësimit dhe pas shpalljes së vendimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Sipas këtij informacioni, të shoqëruar me Notën e nënshkruar nga 3 antarët e trupës së komisionit që ka gjykuar procesin tim të rivlerësimit, është dëshmuar se : *“Trupi gjykues i subjektit Elizabeta Imeraj është shortar më 17 shtator 2018. Seanca dëgjimore për këtë subjekt u zhvillua më datën 24.03.2021 ndërsa deliberation u mbyll më datën 25.03.2021. Në lidhje me organizimin e deliberation ne si trup vëmë në dukje faktin se gjatë gjithë procedurës në fjalë jemi ndjerë të keqardhur dhe të ofenduar nga sjellja jo profesionale, fyese dhe paragjyquese si dhe në tejkalim të çdo kompetence nga vëzhguesi ndërkombëtar. Qëndrimi paragjykues, fyerjet e shpeshita na kanë bërë që të ndihemi j komod dhe nën presion.*

Me qëllimin e tij dhe presionin e ushtruar vëzhguesi në mnyrë të përsëritur ka dashur qartazi të influencojë vendimmarrjen. Kjo sjellje bie ndesh me frymën e deritanishme të bashkëpunimit midis KPK dhe ONM.

Duam të besojmë se ky është një rast i izoluar dhe në asnjë mënyrë një tendencë për intimidim trupi për shkaqe të panjohura. Shprehim besimin e plotë që raste që dëmtojnë procesin e rivlerësimit si dhe bashkëpunimin me ONM të mos përsëritet më”.

Nga njohja me këtë fakt, nuk mundet kurrsesi te mos kem nje objeksion dhe nje vleresim jo me shije te mire, per nje veprimtra i tille.

Absolutisht qe secili ka mendimet e tij dhe analizen e vet juridike, por ndikimi agresiv deri ne fyerje dhe presion nuk arrij do te kuptoj se perse duhet te ekzistoj?

Për të paraqitur lidhjen dhe provën e pasjes së një ndikimi të tillë, i referohem faktit të bërë publik edhe në faqen zyrtare të KPK dhe në seancën publike të zhvilluar në datën 24 mars 2021. Në përfundim të seancës së datës 24.03.2021, shpallja e vendimit u shty për në datën 26.03.2021, por pas paraqitjes në këtë seancë, u njoftova se, për shkaqe *objektive* kjo seancë nuk do të zhvillohej, por do të komunikoj një datë tjetër për këtë fakt.

Ne aktet qe ju keni perpara, rezulton se vendimarrja e KPK se per procesin tim te rivleresimit me konkluzionin Konfirmim ne detyre, eshte bere me date 25.03.2021.

Pas njohjes me denoncimet shtesë nga Kolegji dhe përgjigjet e dhëna nga Prokuroria e Posaçme SPAK, rezulton se, në datën kur ishte caktuar shpallja e vendimit, vëzhguesit ndërkombëtar i depozitohet një *denoncim* me email ndaj meje, me pretendime absurde dhe te paqena, dhe po në këtë datë ky denoncim anonim përmes e-mailit (nga një person që nuk ekziston), i përcillet për verifikim SPAK.

Nuk paraqes dhe nuk shfaq asnjë pretendim në drejtim të verifikimit të çdo të dhënë apo denoncimi, por cfare ka ndodhur qe vendimarrja e dates 25.03.2021 te shtyhej per shpallje deri me date 01.04.2021.

nuk mund të kuptohen ndryshe përveçse një tendencë për të ndikuar në mënyrë jo të rregullt dhe ligjore në procesin tim të rivlerësimit me qellimin e vetem shkarkimin tim nga detyra.

Po kush e deshiron shkarkimin tim nga detyra, bazuar ne denoncimin anonim te Valentino Ymerit, denoncimin anonim te Rrahim Shehut apo denoncimin e Eriona Finos?

Normalisht, une ushtroj detyren dhe funksionin e prokurorit dhe si i tille mundem te kem cenuar dhe interesa politike, interesa ekonomike apo dhe interesa kriminale.

Ndaj pergjigja eshte e sakte, pas denoncimeve anonime mundet te fshihen vetem elemente dashakeqes qe kane pse jo promotorin kryesor tek Krimi i Organizuar.

Por a mundet dhe duhet te shkarkohet nje prokuror mbi bazen e nje karteles te fallsifikuar, mbi bazen e nje denoncimi te paqene, dhe anonim, mbi bazen e pretendimeve qe nuk bazohen ne prova.

Natyrisht qe jo, sepse ne radhe te pare, Ju vete nuk mundet te siguroni besimin e publikut sipas ketij mekanizmi.

MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

II. Sikurse rezulton për një periudhë më tepër sesa 1-vjeçare, hetimi i çështjes time të rivlerësimit, është drejtuar dhe relatuar nga Komisionerja Genta Bungo, e cila mbi kërkesën time fillimisht për ri-shikimin e pozitës së saj, e më pas mbi kërkesën për përjashtim, është përjashtuar nga një trupë tjetër pjesë e Kpk-së.

Pa dashur të detajoj elementë të hetimit të drejtuar prej saj. më rezulton se, mbi të njëjtat akte që kjo komisionere ka relatuar dhe mbyllur hetimin me një kriter, pas largimit të saj është relatuar dhe zhvilluar hetimi për të tre kriteret e rivlerësimit.

Ekzistenca qoftë edhe në dukje e pasjes së konfliktit të interesit të një anëtari trupe, për më tepër kur ky i fundit është relator, (dhe për specifikat që ka ky proces është personi hetues dhe vlerësues i rrethanave), bën që çdo vendimarrje sikurse ishin rezultatet e hetimit në këtë rast, të jenë të afektuara nga ky ndikim i parregullt. Çdo lloj juridiksioni (civil, penal, administrativ), aktin e prodhuar në kushtet e konfliktit të interesit, e konsideron si absolutisht të pavlefshëm. I vetmi që bën përjashtim është Komisioneri Publik i cili nuk sillet si mbrojtës i interesit Publik, por luan rolin akuzator.

Një rrethanë që vëzhguesi ndërkombëtar, e ngre mbi etikën time, lidhet me shkakun se, një ndër arsytet e divorcit që unë kam paraqitur se, ish b/shorti nuk më kishte treguar për pasjen e një konflikti verbal dhe fizik me ish-relatoren, përbën cënim etike, pasi unë duhet të isha më përpara në dijeni të kësaj rrethane. Për këtë VN ka paraqitur Gjetje gjatë shqyrtimit në KPK, dhe e ka rekomanduar këtë edhe për ankim në KPA.

Në fakt, përpos këtij fakti, në qëndrimin e mbajtur nga ish-relatorja Bungo mbi kërkesën për përjashtim është shprehur se *“Subjekti pretendon e sigurtë për një konflikt të vitit 1999 të përsëritur në vitin 2011, por nuk ka dhënë asnjë rrethanë të faktit, asnjë arsye për konflikt dhe aq më tepër kur mendon se ky konflikt kaq i ashpër paska mbetur në mendjen time, së bashku me emrin e bashkëshortit të saj...”*

Ndërkohë është fakt se, për këtë rrethanë ish-bashkëshorti është përjashtur për një vit nga fakulteti i drejtësisë me vendim të Këshillit të Fakultetit, në të cilin ish-relatorja ka mbajtur qëndrimin e saj.

E vlerësuar sa më sipër, konstatohet një çështje jo-etike ndërmjet sjelljes së Vn dhe Ish-relatores Bungo, pasi mundësitë për të rikujtuar një ngjarje janë më të mëdha ndaj një personi që përfshihet verbalisht dhe fizikisht në të, sesa tek një student (një ndër 1 nje mijë studentë që ka pas fakulteti në atë vit) që frekuenton atë fakultet.

Megjithatë ka rezultuar se, rrethana e këtij konflikti më është adresuar *Gjetje* mua si subjekt dhe jo ish-relatores si shkelje në disiplinën e saj, që ka pranuar dhe hetuar një praktikë rivlerësimi në kushtet e konfliktit të interesit.

Sikurse rezulton nga Ankimi i paraqitur nga KP, në çdo rast të konstatimit të barrës së provës, merret në referencë rezultati i hetimit të kryer nga ish-relatorja në kushtet e konfliktit të interesit. Për gjithçka më lart, ky dokument përmban të meta thelbësore si përsa i përket vullnetit mbi të cilin është përpiluar ashtu edhe anës përmbajtësore të tij.

Të ndodhur në kushtet kur relatori, propozuesi i atij materiali është përjashtuar, atëherë rezultatet e tij, nuk mund të përdoren si shkak ankimi apo si baza për daljen në rezultate të ndryshme nga sa ka dalë KPK në vendimin e tij.

III. Më rezulton një mos-konsistencë që nuk mundem si ta përkufizoj ndryshe përsa i përket sjelljes vijuese të disa Komisionerëve dhe VN, përsa i përket rrethanës si më poshtë . Pas përjashtimit të ish-relatores zj.Bungo, KPK, në prezencë të VN, z. Kiljistra me vendimin nr. 4, datë 13.11.2019, vendosi Riçeljen e hetimit përsa i përket kriterit të pasurisë, ndërsa pas administrimit të akteve shkresore dhe shpjegimeve, me vendimin nr. 5, datë 06.02.2020, në prani të VN z. Kiljistra, ka vendosur *Përfshirjen në hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit zj. Elizabeta Imeraj përveç pasurisë edhe dy kriteret e tjera të vlerësimit, atë të figurës dhe aftësive profesionale.*

Rezulton se, 5 (pesë) ditë më pas, në datën 12.02.2020 VN Hans Kiljistra, paraqet në Komision një *Gjetje/opinion* sipas të cilës i kërkohet Komisionit që, të përfundojë me një kriter rivlerësimin dhe të njoftojë Subjektin me barrën e provës vetëm për këtë shkak.

Nga dinamika e veprimeve, dijenisë dhe sjelljes, konstatohet një mos-konsistencë e qartë nga ana e VN, për të cilin edhe objektivisht hetimet nuk mund të sjellin një ndryshim me domethënie thelbësore për një periudhë 5 ditore, edhe pasi janë depozituar te gjitha prapesimet e mia te dokumentuara ne prova, e mbi te gjitha ne kushte kur une nuk disponoj asnje lloj pasurie.

Nëse sjellja e mësipërme, vlerësohet me konformimet, dallohet një praktikë jo e rregullt në drejtimin e zhvillimit të një procesi të drejtë dhe ligjor, që garanton objektivitet, siguri juridike dhe proporcionalitet.

Përsa i përket, procedurës për heqjen dorë të Komisioneres zj. Çiftja, e cila ka ardhur si produkt i një kërkesë të saj, për shkak të *humbjes së objektivitet në gjykim*”, me të drejtë më lind gjithë dyshimi se, kjo paqëndrueshmëri e saj në vlerësimin objektiv të çështjes, e ka pas-shoqëruar këtë zyrtar nga fillimi (kur çështja relatohej nga zj, Bungo) dhe deri në momentin e përjashtimit të saj për shkak dorëheqje.

Fakti i dorëheqjes vetëm për arsye të *humbjes së objektivitetit të saj në gjykim*, të krijojnë dyshimin se kjo mos-konsistencë apo humbje objektiviteti të ketë ndikuar pazgjydhshëmrisht edhe tek VN, qe ka ndjekur procesurën sipas rolit që kanë në Kushtetutë dhe ligj.

Krijimi i gjithë kësaj menyre të vepruari dhe të punuari, në thelb të tyre, e kanë bërë të paragjykuar çështjen time objekt rivlerësimi, nisur edhe nga veprimet e përjashtimit dhe dorëheqjes së dy prej 3 anëtarëve të trupës gjyqësore.

Konkluzione:

Ndryshe nga qëllimi mbi të cilin është miratuar ligji nr. 84/2016 dhe në tërësi paketa e reformës së drejtësi, fokusi i zhvillimit të procesit të rivlerësimit në bazë të kaq shumë dinamikash të parregullta si më sipër, ka larguar vëmendjen nga qëllimi real (ai i rivlerësimit për kriteret e rivlerësimit), duke nxjerrë në pah, praktika plotësisht jo të rregullta, jo etike dhe me pasoja të rënda në dëm të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

Janë konstatuar rrethana të cilat shkojnë në drejtim të :

- Kryerjes së hetimit, relatimit dhe miratimit të një akti (RH), i nxjerrë në kushte të plota të konfliktit të interesit.
- Paraqitjes së një dorëheqje për shkak të *humbjes së objektivitetit të gjykim*, ndërkohë që kryerja e një detyre publike është obligim kushtetues dhe ligjor. Përtej kësaj, ky veprim ndikon domosdoshmërisht edhe në pikëpamjen apo perceptimin që krijohet edhe tek subjektet e tjera pjesë të procesit;
- Ngritjes së pretendimeve, mjaftueshëm të besueshme, për ekzistencën e një fryme paragjyquese, stigmatizuese për shkak origjine dhe përkatësie krahinore, aftësie etj, të cilat gjithashtu ndikojnë pazgjidhshmërisht në një procedurë.
- Bërjes së dukshme të praktikave të parregullta dhe të paligjshme, përse i përket veprimeve që konsistojnë në fshehje të akteve, apo sugjestionimin mbi përfundimet që arrijnë institucione me ndikim në procesin e ri-vlerësimit.
- Ngritjes së shqetësimeve, për zhvillim të punës së tyre dhe vendimmarrjes në kushte kanosjeje apo presioni, të cilat gjithashtu ndikojnë në cënimin e pavarësisë dhe paanësisë së trupës gjyquese, në kuptim kjo të procesit të rregullt ligjor.
- Futjes së akteve të fallsifikuara në proces,
- Berjen e denoncimeve anonime,
- Shtyrjen e seances gjyqesore për shpallje vendimi pas marrjes së vendimit, për arsye të anonimatit denoncues, etj të trajtuara prej meje në rubrikat e tjera.

Konkluzionet e mësipërme, të dëshmuara nga dokumentat e marra si subjekt i interesuar nga KPK, si edhe të bëra publike në media, krijojnë mjaftueshëm bindje të bazuar në unitet të njoftimeve se, Apeli është bërë jo në respektim të normave që lidhen me procesin e rregullt ligjor, sipas ligjit nr. 84/2016.

Te nderuar!

- Edhe pse administrativisht rezultojnë e provuar në mënyrë të qartë, që ska asnjë lloj rrethane që me lidh mua si individ me ndonjë përgjim të mundshëm të Z. Kijlstra, dhe kam depozituar cdo akt në raport me vertetimin e kësaj,
- Edhe pse administrativisht rezultojnë e provuar në mënyrë të qartë, që ska asnjë lloj rrethane që me lidh mua si individ me ndonjë veprim direkt apo indirekt, në drejtim të Komisioneres Ciftja dhe dorëheqjes së saj, kam depozituar cdo akt në raport me vertetimin e kësaj,
- Edhe pse administrativisht rezultojnë e provuar në mënyrë të qartë, që ska asnjë lloj rrethane që me lidh mua si individ me pretendimet e ngritura nga denoncuesi i rreme Rrahim Shehu, dhe kam depozituar cdo akt në raport me vertetimin e kësaj,
- Edhe pse administrativisht rezultojnë e provuar në mënyrë të qartë, që ska asnjë lloj rrethane që me lidh mua si individ me pretendimet e ngritura nga denoncuesi i rreme Valentino Ymeri, dhe kam depozituar cdo akt në raport me vertetimin e kësaj,

- Edhe pse administrativisht rezulton e provuar ne menyre te qarte, qe ska asnje lloj rrethane qe me lidh mua si individ me pretendimet e ngritura nga denoncuesja Eriona Fino e cila ka kerkuar apelimin e vendimit te konfirmimit tim ne detyre me date 27.04.2021, duke njohur detaje akoma pa u zbardhur vendimi i KPK se,

Kam patur guximin ti drejtohem organeve hetimore duke kerkuar hetim te plote, rezultatet duhet te kerkohen dhe te merren nga ana juaj.

Vetem hetimi i plote dhe objektiv tregon nese ka patur pergjim te Z. Kijlstra, dhe kush e ka bere, nese ka patur ndikim tek Znj. Ciftja dhe kush e ka bere ate, si dhe hetimin se kush jane personat anonime qe shkruajne letra me permbajtje te fallsifikuar me qellimin e vetem per te perdorur organet e drejtesise per te realizuar padrejtesine.

MBI RESPEKTIMIN E VENDIMIT TE GJYKATAVE

Nga ana tjeter, pafajesia e formes se prere, nuk komentohet nga asnje lloj personi dhe nuk le as vend dhe as hapesire per interpretim nga askush.

Kjo eshte dhe ne frymen e respektimit te parimeve te shtetit te se drejtes pasi nje vendim i formes se prere ka karakter te detyrueshem qofte dhe ne interpretim.

DIJENIA DHE PADIJENIA E NJE PERSONI SI KONCEPT

E mbi te gjitha, dalja ne konkluzione mbi Dijenine apo padijenine e dikujt, duhet te behet duke marre per baze aspektin psikologjik te cilin po e shtjellojme sa me poshte:

Vëmendja është 'përqendrimi dhe fokusimi i përpjekjes mendore që zakonisht rezulton në ndërgjegjësimin e disa aspekteve të stimujve të jashtëm shqisor ose përvojave mendore.

Në vetvete vëmendja, është një proces i ndërlikuar, me shumë elementë të ndërthurura, që pasojnë njëri-tjetrin dhe bëjnë të mundur, relaizimin e njohjes, për ta përshtatur individin me mjedisin ku punon dhe vepron. Këto elementë, kanë të bëjnë me nivelet e veprimeve të vetëdijshme, me proceset e kontrolluara dhe automatike të vëmendjen, me familjarizimin ose jo të individit me sednet dhe me objektet e njohjes së tij.

Ekzistojnë dy lloje vëmendjeje:

1. Vëmendje e përqendruar/selektive: përqendrohet në mënyrën se si fokusohet vëmendja në një stimul të caktuar hyrës, pse është selektiv dhe çfarë ndodh me stimujt që nuk ndiqen.
2. Vëmendja e ndarë: shikon se si mund t'i kushtohet vëmendja më shumë se një stimuli hyrës dhe cilat janë kapacitetet për këtë.

I ngjan idesë se ne kemi një fushë të vogël shikimi dhe është e vështirë të shohësh gjëra jashtë këtij rajoni të qendrës së vëmendjes, megjithëse vëmendja mund të zhvendoset duke lëvizur këtë dritë.

Psikologët besojnë se e lidhur ngushtësisht më vëmendjen është PERCEPTIMI, i cili përmbledh një sërë procesesh përmes të cilave ne njohim, organizojmë dhe kuptojmë sensacionet, ngacmimet apo informatat që marrim nga stimuli mjedisor.

Më të njohurat dhe të studiuarat, janë:

- Perceptimi vizual (pamor)
- Perceptimi audiovizual (dëgjimor)

Për të kuptuar disa nga aspektet më themelore të perceptimit, psikologët kanë studiuar situata të veçanta që kanë të bëjnë, me të kuptuarit e shqisave tona. Kështu shpesh ne nuk mund të perceptojmë atë që ekziston dhe shpeshherë perceptojmë atë që nuk ekziston.

Ekzistenca e këtyrë iluzioneve tregon se çfarë shohim në organet e shqisave tona, nuk është e njëjtë me atë që kuptojmë. Mendja jonë, duhet të marr informacionin e nevojshëm shqisor dhe ta përpunoj atë për të krijuar një prezantim mendor të objekteve dhe të lidhjeve hapësinore me mjedisin. Për shkak me rradhë, njerëzit kanë kuptuar se çfarë perceptojnë është disa herë më ndryshe nga stimuli shqisor që arrijn tek receptorët. Për këtë arsye nuk janë të vetmit që kanë kuptuar disa ligje themelore të perceptimit.

Lidhur me proceset perceptuese normale, psikologët konjitivë, kanë studiuar perceptimin tek subjekte jonormale, persona tek të cilët proceset perceptuale ndryshojnë nga norma.

Të tillë janë personat që vuajnë nga agnosia, domethënë, që kanë mungesë të dukshme në aftësinë për të perceptuar informacionin shqisor.

Njihen disa lloje agnosie dhe jo të gjitha janë të dukshme. Njerëzit me agnosi vizuale, kanë sensacione normale të asaj ç'ka ndodh përpara tyre, por nuk mund ta kuptojnë atë që shohin. Frojdi (1953) që ishte i specializuar në neurologji, para se të zhvillonte teorinë e tij psikoanalitike të personalitetit, vuri re se disa nga pacientët e tij, ishin të paafte për të identifikuar objekte të zakonshme edhe pse ata dukej se nuk kishin shqetësime psikologjike apo dëmtime në aftësitë e tyre pamore. Në të vërtetë, njerëzit që vuajnë nga agnosia mund të dallojnë të gjitha pjesët e fushës vizuale por për objektet që ata shohin, nuk thonë asgjë.

Nisur nga sa më sipër, ndalova të bëj një analizim të plotë mbi Dijenine dhe Padijenine, nisur nga koncepte psikologjike, për të konkluduar, se për faktë, rrethana, të cilat nuk janë as të dukshme, dhe as mundet të kuptohen, përveçse me një komunikim të drejtepërdrejtë, nuk mundet kurrsesi të konkludohet në rezultate kategorike absolute dhe as relative. Për rrjedhojë ky rezultat, nuk mundet të konkludohet kategorikisht as nga specialiste të fushës perkatese, që gëzojnë njohuri të posaçme.

E bëjmë këtë arsyetim duke e parë këtë situatë të lidhur ngushtë me Gjetjen e datës 04.02.2022 të Vezhguesit Nderkombëtar, i cili konkludon se:

- Mund dhe duhet lehtësisht të dija,

Po dhe në këndvështrimin e nenit 49 që parashikon Gjetjen, apo dhe interpretimet e bëra nga Komisioneri Publik se Gjetja përfaqëson një mendim ekspert, në rastin konkret përcaktimin e aspektit psikologjik mbi Dijenine dhe Padijenine në mungesë të çdo rrethane objektive, mundet ta përcaktojë vetëm një ekspert me njohuri të posaçme në fushën perkatese, madje dhe ky jo me një mendim kategorik.

MBI BESIMIN E PUBLIKUT

Perceptimi tek një koncept i tillë sic është Besimi i Publikut, apo dhenia e kuptueshmërisë për këtë koncept lidhet në dy momente kryesore:

- Ana Formale
- Ana permbajtësore.

Nga pikpamja e anës formale, respektimi, sjellja korrekte, komunikimi ndervazhdues, llogaridhenia edhe me perballje, mat reagimin e publikut që përket në besim ose jo.

Nga pikpamja permbajtësore, janë veprimet e perditeshme të kryera në çdo fazë të punës së një prokurori, duke përfshirë dhe punën time si prokuror.

Por në të dy këto elemente, matshmeria e besimit publikut që të jetë një koncept real dhe jo teorik apo abstrakt duhet të realizohet përmes metodave të kërkimeve të ndryshme të njohura dhe gjithë pranuar.

Ne kete menyre, ne nje paralelizem te thjeshte, matshmeria politike shprehet me vote, matshmeri artistike shprehet me duarttrokitje, matshmeria sportive shprehet me pjesmarrje ne stadium.

Ndersa ne rastin konkret ne reference te normave ligjore, dhe ne perceptimin Tuaj jo tashme si anetare te Gjykates Kushtetuese por si publik i thjeshte, matshmeria e besimit duhet te derivoje ne metoda konkrete.

Per te qene sa me objektive ne kete drejtim, jo vetem per nje lloj provueshmerie para Jush por dhe per nje konkluzion qe lidhet posacerisht me ndergjegjen personale, kemi perdorur metodat e mirenjohura per realizimin e nje matjeje te tille, sic jane:

- Anketimi ne publik me pyetje konkrete.
- Matshmeria per efekt intervistimi ne nje konkurim te pritshem per publikun, intervista per ne SPAK.
- Analizimi i qendrimit publik ne rrjetet e komunikimit masiv.

Konkluzionet e pikes se pare jane pjese e dosjes te dorezuar prej meje gjate gjykimit ne Kpk. Edhe konkluzionet e pikes se dyte jane gjithashtu pjese e dosjes te dorezuar prej meje ne KPK. Ndersa rishtazi, kerkoj prej Jush te administrohen dhe konkluzionet qe lidhen me matshmerine konkrete mbi besimin e publikut sipas paraqitjes ne rrjetet e komunikimit masiv.

Keto konkluzione perfshijne vitin e fundit nga data 01.01.2021 deri me date 01.03.2022.

Nga ana tjeter, ne lidhje me Besimin e Publikut, bej me dije se qe ne gjykimin ne shkalle te pare eshte zhvilluar personalisht prej meje nje anketim e cila eshte pjese e dosjes qe keni perpara nga e cila rezulton se pyetjes:

- A besoni ju tek prokurorja Elizabeta Imeraj?

I jane pergjigjur pozitivisht 3333 tre mije e treqind e tridhjetete e tre persona.

Ky eshte publiku qe me njeh, qe jetoj me ta ne komunitet, ne shqipen tone te bukur dhe qe realisht ka besim tek puna ime si prokuror.

Normalisht qe ka vend per permiresim si per cdo gje.

Nga ana tjeter, po prape per besimin e publikut kam vene ne dispozicion qe ne KPK, matesin e pavarur prej meje te besimit te publikut ne intervistimin tim para KLP se, si kandidatet per ne SPAK, nga ku rezulton se intervista e dhene prej meje, eshte ndjekur nga 27 mije shtetas shqiptare, te cilet smundet te perfaqesojne dhe te lexohen ndryshe vetem si Publik qe beson ne punen time.

Dhe se fundi si nje rrethane e re qe lidhet me besimin e publikut, me qellim te realizimit te qetesise time personale, duke marre ne konsiderate berjen mediatike te procesit tim te rivleresimit, kam marre te dhenat ne lidhje me perceptimin e publikut te shprehur ne reagime, komente, ne rrjete sociale, apo youtube per Elizabeta Imeraj si prokurore e RSH-se.

Ne baze te kesaj matshmerie, e cila eshte reale dhe e aksesueshme nga secili prej nesh, e perpunuar nga nje qender me kerkesen e bere nga ana ime, rezulton se nga 977 publikime ne media te realizuara ne drejtim te personit tim, 89 perqind e publikut ka qasje pozitive karshi meje si prokuror dhe karshi punes time. Vetem 11 perqind e publikut kane mendim negativ duke gjykuar punen time si prokuror.

Bej me dije se ne keto shkrime keni cdo detaj qe lidhet jo vetem me punen time por dhe me qendrimin e mbajtur nga Vezhguesi Nderkombetar me Gjetjet e tij karshi meje ne procesin e rivleresimit.

Bej me dije gjithashtu se pjese e shkrimeve jane dhe cdo pretendim i paraqitur nga vazhguesi nderkombetar ne lidhje me:

- Martesen apo zgjidhjen e saj, denimin jo ekzistues te ish bashkeshortit, pasurine qe nuk kam asgje, pergjimin e pretenduar te Z. Kijlstra, qe nuk dime ku eshte etj.

Ne keto kushte, eshte e arsyeshme qe te jemi konkrete kur flasim ne emer te publikut shqiptar, ky publik qe pret, dhe beson qe do permiresohet dhe sistemi i drejtesise.

MBI KRITERIN E PASURISE

Sic e kam shpjeguar dhe sic rezulton nga te gjitha aktet qe ndodhen ne dosje apo dhe ne provat qe kerkoj te administrohen prej Jush, nuk kam patur dhe as nuk kam asnje lloj pasurie as me cilesine e pronarit apo te bashkepronarit. Ju do konstatoji personalisht sesi me dashakeqesi ose pakujdesi nje kartele pasurie e fallsifikuar eshte administruar ne dosje, madje ka sherbyer si shkak ku Komisioneri Publik mbeshtet Apelimin e tij per kriterin e pasurise. Por kur behet fjale per rrethana konkrete, duhet tu referohemi fakteve dhe akteve konkrete, pasi ketu nuk mundet kurrsesi te ecim me perceptime.

Sidoqofte, kartela e pasurise e fallsifikuar si e leshuar ne emrin tim me date 20.08.2013, tashme eshte objekt hetimi, pas kallezimit te depozituar nga ana ime ne organet kompetente. Sidoqofte, meposhte keni nje analize te detajuar, jo vetem te shpjegimit te shkaqeve te Apelimin ne rang teorik por dhe analize konkrete te te ardhurave ne raport me shpenzimet, nga te cilat rezultojne ne menyre te qarte:

- Se deklarimi i bere nga ana ime ne lidhje me kete kriter eshte i sakte, ne peruthje me ligjin,
- Ka burime te ligjshme finaciare,
- Dhe nuk gjendem ne asnje rast ne kushtet e konfliktit te interesit.

Persa me siper, duke qene se nga KP ne apelimin e bere jane ngitur si pretendime, pamjaftuesmerie per shkak analizimi te disa te ardhurave nga qeraja, eshte e e domosdoshme te administrohen si prova:

- Interpretimi i bere nga organi kompetent,
- Mendimi i shprehur ne akt nga nje ekspert me njohuri te posacme per analizen finaciare,
- Aktet bashkeshoqeruese te ketij raporti financiar.

MBI RESPEKTIMIN E PARIMIT TE BARAZISE PARA LIGJIT

Edhe pse ne menyre jo logjike KP, ne arsyetimin e apelimin qe ben kunder vendimit me Nr 363 te dates 01.04.2021, per praktika tashme te konsoliduara ne KPK, por te konsoliduara dhe ne qendrimet me mosankimim per situatata te ngjashme, edhe ne rastin konkret gjen totalisht respektim parimi i trajtimit ne menyre te barabarte para ligjit.

Me poshte sjellim praktika mbi qendrimin e mbajtur nga institucionet e rivleresimit per pasurine paramartesore.

Me poshte paraqesim:

Praktika e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimin. Raporti që ka dhe duhet të ketë subjekti i rivlerësimit në raport me pasuritë paramartesore dhe më tej akoma, proporcionaliteti i tij për të justifikuar vetëm atë pasuri që ka në pronësi (apo ka realizuar të ardhura apo interes nga kjo pasuri), rezulton të jetë konfirmuar në disa qëndrime të Institucioneve të Vettingut, e për më tepër që tashmë kjo praktikë dhe ky interpretim është i unifikuar. - Vendimi nr. 181, datë 18.07.2019, i KPK, për subjektin e Rivlerësimit E.K, ndër të tjera arsyeton se “...Komisioni vlerëson se, mungesa e burimeve të ligjshme për personin e lidhur, nuk mund të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë nga SR, pasi kjo e fundit provoi me dokumentacion ligjor se martesë ligjore e subjektit... (ka ndodhur pasi është krijuar pasuria e paluajtshme)... Subjekti provoi se nuk ka patur asnjë lidhje interesi midis subjektit dhe personit të lidhur, në momentin e blerjes së këtij apartamenti... Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të Ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, deklarimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit, është në përputhje me detyrimet ligjore që SR ka patur për të bërë në zbatim të legjislacionit...”. - Vendimi nr. 262, datë 17.06.2020, i KPK për subjektin e Rivlerësimit E. P, konfirmon se, të gjitha situatat faktike kur pasuria ka rezultuar e fituar nga personi i lidhur para martesë, pavarësisht se nuk justifikohet burimi i

ligjshëm i krijimit të tyre, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk përbën detyrim e aq më pak shkak për shkarkim të SR, mjafton të provohet mos-pasja në pronësi e këtyre pasurive, apo ndonjë e drejtë tjetër interesi kundrejt tyre. Përveç rikonfirmimit të qëndrimit të mësipërm se, pasuria paramartesore e personit të lidhur, nuk mund ti ngarkohet SR, nga ana tjetër në këtë vendim u mbajt qëndrimi (i cili u gjend i bazuar edhe nga Komisioneri përsa kohë që nuk u ankimua prej këtij të fundit) se, përfitimi i një pasurie paramartesore dhe burimi i krijimit të saj nga personi i lidhur, nuk duhet të lidhen me procesin e rivlerësimit të Subjektit të Rivlerësimit. - Vendimi nr. 8, datë 25.06.2020, i KPA, për SR, A.K, ka konfirmuar përsëri se, Subjektit të rivlerësimit, nuk mund t'i kundrejtohet detyrimi për një pasuri nëse ai nuk shfaq kundrejt saj një marrëdhënie interesi sipas nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, sikurse janë dhurim, huamarrje apo huadhënie.

Nga ana tjetër po ne vijim te respektimit e ketij parimi po sjell ne vemendjen tuaj qendrim te konsoliduara tashme edhe persa i perket vendimarrjes qe lidhet me kriterin e figures, ku vete Komisioneri Publik ka konkluduar me mosankimim te rasteve si me poshte:

Në rastin e vendimarrjes për subjektin e rivlerësimit E.Dh.

Nga vendimi i arsyetuar rezulton se, në të njëjtën linjë arsyetimi dhe konkluzioni rezulton që të ketë arritur edhe Z. John Leonardo, vëzhguesi ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i cili, me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2018, i përshkruan në mënyrë sintetike rrethanat e mësipërme dhe i parashton si të detyrueshme për t'u marrë në konsideratë në përputhje me pikën 3, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.

Edhe ne rastin e subjektit të rivlerësimit K. B është mbajtur si qëndrim:

‘Komisioni, vlerësoi se:

Në deklaratën për kontrollin e figurës, pjesa 5, të dhëna për sigurinë, subjekti ka deklaruar se nuk ka dijeni se një nga anëtarët e familjes është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.

.....Komisioni, bazuar në shpjegimet e subjektit dhe në hetimin e kryer për këtë çështje, krijoi bindjen se subjekti nuk ka pasur kontakte të vazhdueshme me shtetasin E.V. Kjo rrethanë e kontakteve të rralla familjare, se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në dijeni për arrestimin e kunatit E.V., u mor në konsideratë nga Komisioni si rrethanë lehtësuese në përputhje me pikën 5, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni krijoi bindjen se përgjigjet e subjektit të rivlerësimit ishin bindëse, se ai ka qenë i besueshëm, i hapur dhe i plotë në deklaratimet e tij lidhur me dijeninë e arrestimit dhe kontaktet e rralla me shtetasin E.V. Gjatë hetimit Komisioni nuk konstatoi asnjë indice apo të dhënë për dijeninë e subjektit lidhur me arrestimin e kunatit të tij, z. E.V., në vitin 2012’.

Edhe në rastin e subjektit të rivlerësimit S. S është mbajtur e njëjta praktikë, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Sa me sipër, nuk ka asnjë arsye të mendohet se ish-kunati im, për asnjë lloj rrethane të ketë raporte më të afërta me mua, se çka kunati i E. Dh me të, apo kunati i K. B me të, apo djali i tezes së S. S me të.

Per me teper, kur vete vendimi per nje person me emrin Arjan Kadriu eshte dhene ne mungese dhe shume kohe para marteses time.

Në lidhje me sa me sipër, duke kërkuar para JUSH, si niveli me i larte i Gjyqesorit ne RSH – se, kerkoj me ngulm ne kuader te procesit te rivleresimit, hetim te plote, gjykim te drejte dhe mbi te gjitha respektim te DINJITETIT NJEREZOR, ne radhe te pare.

Kerkohet kjo nga nje subjekt qe hyn ne kete proces me barren per te provuar, ne dukje i vogel per mundesine efektive te pergjigjeve, por ne thelb i madh per shkak SE DREJTES QE E KA ME VETE.

Persa i perket, parashtrimeve ne raport me kriteret e rivleresimit si:

- Kriteri i pasurise,
- Kriteri i figures,

- Kriteri profesional,
Bashkangjitur keni trajtimi dhe parashtrimet per cdo kriter dhe kerkesat per prova te cilat, do zbardhin me detaje cdo aspekt.

Përsa më sipër, duke besuar tek gjykimi i Trupës Gjyquese, bazuar në Ligjin 49/2012, Ligjin 84/2016, Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pas shqyrtimit të ankimit dhe parashtrimeve të mia në cilësinë e subjektit të rivlerësimit,

KËRKOJ:

1. Riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja që i shërbejnë hetimit të plotë te ceshtjes duke administruar aktet dhe provat sipas kerkeses per prova bashkelidhur.
2. Lenien ne fuqi te vendimit me Nr 363 te dates 01.04.2021 per konfirmimin ne detyre te subjektit Elizabeta Imeraj.

PROKURORI
Elizabeta IMERAJ